



Në bazë të nenit 7 të Vendimit mbi përcaktimin dhe ndarjen e Çmimit të Komunës „1 Shtatori – Dita e Komunës” („Fleta zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale”, nr. 19/21), Juria për ndarjen e Çmimit të Komunës „1 Shtatori – Dita e Komunës” për vitin 2026, shpall

THIRRJE PUBLIKE

për paraqitjen e propozimit të kandidatit për dhënien e Çmimit të Komunës „1 Shtatori – Dita e Komunës” për vitin 2026

1. Ftohen të gjithë qytetarët, grupet e qytetarëve, shoqëritë afariste, institucionet, sektori joqeveritar, partitë politike dhe subjektet e tjera me vendqëndrim gjegjësisht me seli në territorin e Komunës së Tuzit, të propozojnë kandidatët për ndarjen e çmimit „1 Shtatori – Dita e Komunës”, i cili si formë e veçantë e njohjes publike ndahet me rastin e Ditës së Komunës së Tuzit.
2. Mund të propozohen persona juridikë dhe individë të cilët e kanë selinë, gjegjësisht vendqëndrimin në territorin e Komunës së Tuzit ose jashtë tij, për rezultatet më të mira të realizuara dhe kontributin e dhënë për zhvillimin e Komunës në fushën e afarizmit, shkencës, arsimit, shëndetësisë, kulturës, sportit, dhe fushave të tjera të jetës shoqërore, sipas vlerësimit të propozuesve, e që kanë vlerë të veçantë për Komunën e Tuzit.
Çmimi mund t'i ndahet personit të njëjtë vetëm një herë.
Në rast se për këtë ekzistojnë arsye veçanërisht bindëse, Çmimi mund të ndahet edhe pas vdekjes.
3. Propozimet për ndarjen e Çmimit të Komunës „1 Shtatori – Dita e Komunës” dorëzohen në formë të shkruar krahas arsyetimit dhe dokumentacionit në bazë të cilit Juria mund të vlerësojë rezultatet të arritura të kandidatëve të propozuar.
4. Propozimet dorëzohen drejtpërsëdrejti në arkivin e Komunës së Tuzit ose përmes postës në zarf të mbyllur në adresën: Komuna e Tuzit – Juria për ndarjen e Çmimit të Komunës „1 Shtatori – Dita e Komunës”, Tuz, Rruga nr. 1/44, 81206, më së voni deri me 14.08.2026.
5. Kjo thirrje publike do të publikohet në ueb faqen e Komunës së Tuzit www.tuzi.org.me, përmes transmetuesit lokal TV Boin dhe në tabelën e publikimeve të Komunës. Formulari mund të merret drejtpërsëdrejti në arkiv ose në ueb faqen e Komunës.
6. Për informacione shtesë mund të kontaktoni në numrin e telefonit 020/875-167 dhe përmes e-mail-it tuzi@tuzi.org.me.

**JURIA PËR NDARJËN E ÇMIMIT TË KOMUNËS
„1 SHTATORI – DITA E KOMUNËS”**